



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “KËRKIM, SHPIM DHE
SHFRYTËZIM PËR NAFTË, GAZ DHE UJË”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”**, me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar **“Teori profesionale e integruar”** të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e **“Teorisë profesionale të integruar”** bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë gazi dhe uji”**, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe klasa e 11-të).
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë gazi dhe uji”**, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 **“Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”**.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”**, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të **“Teorisë profesionale të integruar”** të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”** do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli I, bazë, niveli II, mesatar dhe niveli i III, i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen

parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte gazi dhe uji” do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Gjeologji e përgjithshme, kl. 10;
2. Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit, kl. 10, kl. 11 dhe kl.13;
3. Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit, kl. 10, kl. 11;
4. Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Gjeologji e përgjithshme	58	21
2	Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit	95	35
3	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	90	33
4	Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit	31	11
	TOTALI	274	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) “Gjeologji e përgjithshme” kl. 10: (58 orë)**
- Njohuri të përgjithshme për mineralet 10 orë
 - Përshkrimi i shkëmbinjve sedimentarë 10 orë
 - Përshkrimi i shkëmbinjve metamorfikë 3 orë
 - Forma, vetitë fizike, përbërja kimike dhe ndërtimi i brendshëm i Tokës 4 orë

• Proceset gjeologjike të jashtme (ekzogjene)	17 orë
• Proceset gjeologjike të brendshme (endogjene)	14 orë
b) “Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit”, kl.10 , kl.11 dhe kl.13:	(95 orë)
➤ Llojet e puseve te shpimit dhe metodat e shpimit:	10 orë
• Shpimi i puseve, realizimi praktik i tyre	(4 orë)
• Llojet e puseve që shpohen	(2 orë)
• Metodot e shpimit te puseve (klasike dhe eksperimentale)	(4 orë)
➤ Kolonat e shpimit, funksionet, përbërja e tyre:	10 orë
• Kolonat e shpimit , funksionet	(4 orë)
• Përbërja e kolonave te shpimit (tubat)	(4 orë)
• Elementët lidhës të kolonave të shpimit	(2 orë)
➤ Instrumentet shkëmbshkatërrues:	6 orë
• Funksionet e instrumenteve shkëmbshkatërrues	(2 orë)
• Llojet e instrumenteve shkëmbshkatërrues	(4 orë)
➤ Lëngjet larës, funksionet, llojet e lëngjeve larës:	10 orë
• Lëngjet larës, funksionet e tyre	(2 orë)
• Llojet e lëngjeve larës	(4 orë)
• Përbërësit e lëngjeve larës	(4 orë)
➤ Kompleti karotier, ndërtimi, funksionimi:	14 orë
• Funksionet e kompletit karotier	(4 orë)
• Ndërtimi i kompletit karotier	(4 orë)
• Krijimi dhe strehimi i kampionit gjatë shpimit	(3 orë)
• Këputja dhe ngritja e kampionit, zbërthimi në sipërfaqe	(3 orë)
➤ Konstruksioni i pusit dhe tubimi:	10 orë
• Konstruksioni dhe qëllimi i konstruksionit të puseve	(3 orë)
• Llojet e kolonave te rrethimit në përbërje të konstruksionit	(3 orë)
• Tubat e rrethimit, si përbërëse të kolonave të rrethimit	(4 orë)
➤ Çimentimi i kolonave të rrethimit:	10 orë
• Qëllimi i kryerjes së çimentimit të kolonave të rrethimit	(3 orë)
• Llojet e çimentimve në pusët e naftës, gazit dhe ujit	(3 orë)

- Mënyrat e çimentimit të kolonave të rrethimit (4 orë)

Klasa13

(25 orë)

- Projekti i shpimit të një pusi 4 orë
- Sistemi i qarkullimit dhe pastrimit të lëngut larës 3 orë
- Infrastruktura e sigurimit teknik në sondë 2 orë
- Hermetizimi i grykës së pusit. Preventorët 2 orë
- Ekuilibri i presioneve në pus me presionin e shtresës 3 orë
- Shpimi i puseve të orientuar dhe horizontale 4 orë
- Shpimi i puseve për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore 3 orë
- Parandalimi i ndërlikimeve dhe avarive gjatë shpimit të pusit 2 orë
- Kompletimi i trungut të pusit dhe grykës së pusit në rastet e lënies së pusit në konservim. Braktisja e pusit 2 orë

c) **“Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, kl.10, kl.11: (90 orë)**

- **Metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës 8 orë**
 - Shfrytëzimi i puseve të naftës me errupsion natyror (3 orë)
 - Shfrytëzimi i puseve të naftës me errupsion artificial (2 orë)
 - Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompë thellësie (3 orë)
- **Vënia e puseve në shfrytëzim 10 orë**
 - Skema sipërfaqësore e pajisjeve të nevojshme për vënin e puseve në shfrytëzim (5 orë)
 - Vënia e një pusi nxjerrje naftë në shfrytëzim (5 orë)
- **Teknologjia e shfrytëzimit të puseve të naftës me errupsion natyror 10 orë**
 - Përgatitja e pusit dhe operacionet (5 orë)
 - Vënia në punë e pusit dhe skema e grumbullimit (5 orë)
- **Teknologjia e shfrytëzimit të puseve të naftës me errupsion artificial: 8 orë**
 - Përgatitja e pusit dhe pajisjet e shtytjes e ajrit (4 orë)
 - Skema teknologjike dhe nyjet e saj (4 orë)
- **Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompë thellësie 10 orë**
 - Pompat e thellësisë (4 orë)
 - Kolona e tubove (3 orë)
 - Kolona e purtekave (3 orë)

- **Sistemi pompë-lëkundës për nxjerrjen e naftës** **10 orë**
 - Pjesët lëvizëse të lëkundësit (5 orë)
 - Bazamenti i lëkundësit dhe kulla (5 orë)

- **Shfrytëzimi me pompë thellësie me purteka** **12 orë**
 - Klasifikimi i pompave të thellësisë (4 orë)
 - Shfrytëzimi normal (4 orë)
 - Shfrytëzimi periodik (4 orë)

- **Metoda të tjera të shfrytëzimit të pusit me pompa pa purteka** **8 orë**
 - Pompat zhytëse (4 orë)
 - Pompat me burmë (4 orë)

- **Grumbullimi, transporti dhe trajtimi i naftës e gazit:** **14 orë**
 - Nxjerrja e naftës dhe grumbullimi në grupin e prodhimit (4 orë)
 - Transporti i naftës e gazit në grup (4 orë)
 - Trajtimi i naftës e gazit në grupet e grumbullimit (3 orë)
 - Pompimi i naftës për në stacionin qendror të grumbullimit (3 orë)

- d) “Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit” klasa 13:** **(31 orë)**
 - Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës me errupsion natyror. Organizimi i punimeve, skema, pajisjet, sistemi i grumbullimit, gazndarja dhe transporti i fluideve. Skema e transportit nga pusi në uzinat e përpunimit. Monitorimi i proceseve. 4 orë.
 - Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës me pompa thellësie. Organizimi i punimeve, skemat e shfrytëzimit. Menaxhimi i punimeve nxjerrjes së naftës. Pajisjet, lëkundësit, pompat e thellësisë. Monitorimi i proceseve. 4 orë
 - Planifikimi i proceseve dhe operacioneve të remontit dhe të mirëmbajtjes së puseve për të minimizuar ndalesat e puseve duke organizuar gjithë kapacitetet për të rritur koeficientin e shfrytëzimit të puseve. 4 orë
 - Mirëmbajtja (remonti) e zakonshme dhe kapitale e puseve. Organizimi i punimeve të kryera në sipërfaqe, në trungun e pusit dhe në fund të pusit. 4 orë
 - Skemat e kryerjes së proceseve të stimulimit. Kryerja dhe monitorimi i proceseve. 3 orë
 - Metodatat e veprimit në shtresë. Injektimi i ujit. Realizimi i procesit, kontrolli dhe monitorimi. 4 orë
 - Injektimi i avullit. Gjeneratori i avullit. Realizimi i procesit, kontrolli dhe monitorimi. 4 orë
 - Djegia nëntokësore. Realizimi i procesit, ndezja e shtresës, injektimi i ajrit. Kontrolli dhe monitorimi. 4 orë